



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 49/2 Prot.

Tiranë, më 08.01.2026

VENDIM

Nr. 2 Datë 08.01 2026

“PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë" nenit 49, pika 1, gërma (ç) në Statutin e UST-së neni 43, gërma (ll), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", në Vendimin e Senatit nr.13, datë 28.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2025, të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", të ndryshuar, në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1647/1 prot., datë 15.12.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1725/1 prot., datë 30.12.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1726/1 prot., datë 30.12.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar", në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1727/1 prot., datë 30.12.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor", në Vendimin e Senati Akademik nr. 5 datë 08.01.2026 "Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 08.01.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si më poshtë:
 - **Znj. Keida Petrit Ushtelenca**, personel akademik pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, me gradë shkencore "Doktor" kalon me titullin akademik "Profesor i Asociuar" nga data 15.12.2025 e në vazhdim.

- **Znj. Marsela Shyqyri Shehu**, personel akademik pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 30.12.2025 e në vazhdim.
 - **Znj. Entela Ruzhdi Kushta**, me detyrë Drejtuese e Departamentit të Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 30.12.2025 e në vazhdim.
 - **Z. Robert Xheladin Citozi**, personel akademik pranë Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, me titullin akademik “Profesor i Asociuar” kalon me titullin akademik “Profesor” nga data 30.12.2025 e në vazhdim.
2. Efektet financiare shtrihen nga data e përfitimit të titullit akademik dhe në zbatim të VKM me nr.243, datë 20.04.2023, “*Për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë*”, të ndryshuar, Lidhja nr.1.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

NË MUNGESË DHË ME POROSI

Dr. Marsela SHEHU

